

VENDIM
Nr.552, datë 11.8.2011

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.455, DATË 18.7.2007 “PËR
PAGAT DHE SHTESAT MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PYJOR”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.455, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Shërbimit Pyjor”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Renditja e funksioneve organike sipas klasave të pagave, për punonjësit e drejtorive të Shërbimit Pyjor sipas kategorive, shtesa për funksion drejtues dhe shtesa për kushte të veçanta të shërbimit, përcaktohen sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij”.

c) Pas pikës 5 shtohet pika 5/1, me përmbajtje:

“5/1. Punonjësit e Shërbimit Pyjor, përfitojnë shtesë për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin, sipas përcaktimit të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore. ” .

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për rritjen e pagave për vitin 2011.

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 15 korrik 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha